



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Nr. 2744 / Prot
1

Tiranë, më 26 / 10 / 2020

Lënda: Njoftim për vend të lirë pune

DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN

Në zbatim të Ligjit Nr.15/2019 “Për nxitjen e Punësimit”, Ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit të Këshilli të Ministrave nr.554, datë 31.07.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”, Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 11, datë 3.3.2020 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional”, Urdhërit nr.172, datë 24.12.2019 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”, i ndryshuar me Urdhërin nr. 107, datë 13.08.2020 dhe shkresës nr.712 prot, datë 19.10.2020 “Njoftim për vend të lirë”, të Shkollës së Mesme Teknike Ekonomike Tiranë, protokolluar pranë AKPA-s me nr.2744 prot, datë 21.10.2020, ju lutem procedoni me shpalljen e njoftimit për vendin e lirë në portalin e AKPA-së, brenda datës 27.10.2020, si më poshtë:

Pozicioni i punës:

- Nëndrejtor i kulturës profesionale në drejtimin Ekonomi-Biznes

Kandidati aplikues për pozicionin e punës Nëndrejtor i kulturës profesionale, në Shkollën e Mesme Teknike Ekonomike Tiranë, duhet të përmbushë kriteret si më poshtë:

1. Kriteret të përgjithshme:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- f) të demonstrojë aftësi të organizimit dhe planifikimit strategjik, aftësi analitike për zgjidhjen e problemeve;
- g) të demonstrojë aftësi drejtuese, të punës në grup dhe motivimit.

2. Kriteret të posaçme për nëndrejtorin, që mbulon kulturën profesionale:

a) të ketë diplomë të studimeve universitare të nivelit “Master shkencor” (ose të barasvlershme) për një nga profesionet që lidhet me drejtimet profesionale të ofruesit të AFP-së;

b) të ketë të paktën kategorinë “Mësues i kualifikuar”;

c) të ketë punuar të paktën 5 vjet në një ofrues të AFP-së;

d) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

e) të ketë përvojë pune të paktën 3 vjet në fushën profesionale të njërit prej kualifikimeve profesionale të ofruesit të AFP-së.

3.Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

a) letër motivimi për pozicionin;

b) CV (jetëshkrimi), i cili plotësohet sipas formatit në shtojcën 1 të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 11, datë 3.3.2020 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional”;

c) fotokopje e kartës së identitetit, e diplomës dhe e librezës së punës;

d) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;

e) certifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;

f) vërtetim të gjendjes shëndetësore;

g) vërtetim të gjendjes gjyqësore;

h) vërtetim nga punëdhënësit e mëparshëm, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi;

i) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Dokumentet e aplikimit të dorëzohen në zyrën e protokollit të Shkollës së Mesme Teknike Ekonomike Tiranë brenda datës 05.11.2020.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Elira DEMIRAJ